



**ALBGAS sh.a.**

**OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR**

**ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË**

Nr. 83 Prot  
1

Tiranë, më 31/03/2022

**RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË**  
**2021**

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit  
Natyror nga ALBGAS Sh.a.**

ALBGAS Sh.a  
Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror  
Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovarëve,  
Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri  
[www.albgaz.al](http://www.albgaz.al)  
NUIS: L71306034U

# **RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË**

## **2021**

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit  
Natyror nga ALBGAZ Sh.a.**

**Tiranë, 2022**

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAZ Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tij në vitin 2021. **Duke qënë se mandati i Zyrtarit mbaroj më 18.11.2021, ky raport do analizoj atë afat kohor.**

Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE nr.77, datë 26.05.2017, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAZ Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

**Përgatiti:**

**Elvis Ponari MBA, MSc**

**Zyrtari i Përputhshmërisë**

**Email:** elvis.ponari@gmail.com

## **SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME**

**ALBGAZ sh.a:** Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Nat.

**ALBPETROL sh.a:** Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit

**ERE:** “Enti Rregullator i Energjisë”

**OSSH/DSO:** “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”

**ALBGAZ/TSO:** “Operator i Sistemit të Transmetimit”

**ENTSO-G:** është Rrjeti Europian i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (observer)

**MIE:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

**GNL:** “Gaz Natyror i Lëngshëm”

**MEDREG:** Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut

**ECRB:** Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë

**ACER:** Agjencia për kooperim e rregullatorëve të energjisë për Europën.

**CEER:** Këshilli Europian i Rregullatorëve të Energjisë

**GRI SSE:** Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje

**IGU:** Unioni Ndërkombëtar i Gazit, jemi anëtarë me të drejta të plota

**OME:** Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë

**UfM:** Unioni për Mesdheun

**Përmbajtja**

<b>PJESA E PARË</b> .....	6
<b>1. Hyrje</b> .....	6
<b>2. Shoqëria</b> .....	8
<b>3. Programi i Përputhshmërisë</b> .....	9
<b>A. Ndarja dhe pavarësia</b> .....	10
<b>1. Ndarja</b> .....	10
<b>2. Pavarësia drejtuese</b> .....	11
<b>3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse</b> .....	11
<b>B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese</b> .....	17
<b>1. Aksesimi në sistemin e transmetimit</b> .....	17
<b>2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale</b> .....	17
<b>3. Konflikti i interesit</b> .....	18
<b>C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ</b> .....	18
<b>1. Sigurimi i informacionit</b> .....	18
<b>2. Konfidencialiteti i informacionit</b> .....	19
<b>3. Informacioni publik</b> .....	19
<b>D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë</b> .....	20
<b>PJESA E DYTË</b> .....	21
<b>4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë</b> .....	21
<b>PJESA E TRETË</b> .....	21
<b>6. Detyrat specifike të lëna nga ERE për vitin 2022.</b> .....	21
<b>PJESA E KATËRT</b> .....	22
<b>7. Konkluzione</b> .....	22

---

## PJESA E PARË

---

### 1. Hyrje

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015), në zbatim të kërkesave të nenit 47, Programi Tip i Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”. Gjithashtu në mbështetje të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC” u hartua ky raport. Raporti vjetor u hartua në bazë të detyrave të Zyrtarit të Përputhshmërisë, Z. Elvis Ponari MBA, MSc (Zyrtari), miratuar me Vendimin Nr. 233, datë 16.10.2018, “Mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së ALBGAS të Gazit Natyror nga ERE.

Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet për herë të katër si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë “ALBGAS” sh.a. (ALBGAS) në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të ALBGAS në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2020 nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAS me vendim Nr.18, datë 04.11.2020 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar në ERE me vendim nr. 263, datë 28.12.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, ‘Albgaz’ sh.a’.

*Programi nxjerr një Raport vjetor, i cili bazohet në sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të ALBGAS-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisht së ALBGAS, konfidencialitetin e të gjithë informacionit të menaxhuar nga ALBGAS-ja si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj përgjatë periudhës **1.1.2021 – 18.11.2021.***

*Zyrtari konstantoi që ALBGAS është në përputhje me standartet e industrisë, ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2021 e analizoj kompaninë sipas Programit dhe ushtroi detyrën e tij që Programi të zbatohet nga kompania. Gjithashtu përgjatë 2021 Zyrtari është kujdesur që kompani të respektoj dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari sëbashku me ALBGAS kanë bashkëpunuar për të krijuar rregullore, udhëzime, trajnime, prezantime, dhe procese në mënyrë aktive në mënyrë që kompania dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshmëri me Programin.*

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

Raporti i vitit 2020 parashtrori disa rekomandime që duhet të ishin plotësuar përgjatë 2021. Për përmirësimin e punës në ALBGAZ dhe përmbushjet e detyrimeve të Programit. Këto rekomandime do shqyrtohen në këtë raport.

Rekomandimet ishin:

- Përditësimi i faqes zyrtare të ALBGAZ për të përfshirë Programin e Përputhshmërisë
- Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin
- Udhëzues për Politikën e klasifikimit të dokumentacionit
- Përditësim/përmirësim i Programit
- Aplikacion/mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.

Sipas komunikimit të vazhdueshëm midis Zyrtarit dhe ALBGAZ dhe me shkresën kthim përgjigje “Dhënie informacioni për masat e marra për rekomandimet e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë për vitin 2021” nga ALBGAZ, Nr. Prot 189, datë 03.11.2021 thuhet:

- **Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin**

Kodi i Etikës aktual i përdorur nga ALBGAZ është shumë i mirë por kërkon një përmirësim duke shtuar pjesë nga Programi i Përputhshmërisë. Do shikohet përgjatë vitit 2022.

- **Përditësim/përmirësim i Programit**

Programi është një produkt i ri dhe kërkon sipas kohës të përditësohet dhe të kihet parasysh që të jetë sa më koherent me standardet e industrisë.

Përgjatë vitit 2021 vëj në dukje komunikimet më të rëndësishëm për ALBGAZ me ERE dhe përsa i përket përputhshmërisë.

- duhet vënë në dukje që ere me vendim nr. 6, datë 15.01.2021 mbi kërkesën e shoqërisë albgaz për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ere nr.100/2019
- duhet vënë në dukje që ere me **vendim nr. 63**, datë 01.03.2021 mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ere-s në lidhje me miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, albgaz sh.a. dhe **vendim nr. 236**, datë 26.11.2021 mbi zgjatjen e afateve të përcaktuara në vendimin e bordit të eres nr. 171, datë 16.08.2021, “për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “albgaz” sh.a. dhe **vendim nr. 171**, datë 16.08.2021 mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “albgaz” sh.a.
- duhet vënë në dukje që ere me **vendim nr. 85**, datë 30.03.2021 mbi zgjatjen e afatit të dorëzimit të programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, albgaz sh.a.
- përsa i përket licencimit dhe certifikimit kemi vazhdimësi komunikimi me **vendimet e ere nr. 152**, datë 30.06.2021 mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ere-s nr. 179, datë 08.11.2017, “mbi çertifikimin e shoqërisë “operatori i kombinuar i gazit natyror” albgaz sh.a.”, i ndryshuar **dhe vendimi nr. 201**, datë 01.10.2021 mbi një ndryshim në vendimin e

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

bordit të ere-s nr. 187, datë 10.11.2017, “për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar. me **vendimin e ere nr. 153** kemi një ndryshim në vendimin e bordit të ere-s nr. 187, datë 10.11.2017, “për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe në vendimin e bordit të ere-s nr.188, datë 10.11.2017, “për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar

- duhet vënë në dukje që ere me **vendim nr. 195**, datë 22.09.2021 mbi kërkesën e shoqërisë “albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ere, për licencimin e shoqërisë “albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror
- Duhet theksuar se Shoqëria “Albgaz” sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 138/1 prot., datë 01.12.2021 ka kërkuar që për vitin 2022 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit. ERE me vendim nr. 254, datë 21.12.2021 mbi “Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a.”
- Duhet theksuar dhe ripërmënduar që ALBGAZ dhe ALBPETROL kanë dhe janë të vetmit të treg që trasmentojnë gaz me pagesë. Për sa i takon konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale, përgjatë vitit 2021 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të veçanta. Aktivitetet e Albgaz sh.a. nuk kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror në vend. Sikurse theksohet më sipër, shoqëria Albgaz sh.a ka vetëm një kontratë me shoqërinë Albpetrol sh.a. ALBGAZ duke mos patur rrjet gazi dhe atë që ka e ka me kapacitet minimal një nga klientët e tij dhe më të rëndësishmit është ALBPETROL. Bashkëlidhur gjeni shkresën dërguar ERE me nr.166 prot., “Kërkesë për miratimin e kontratës së transmetimit”.

## 2. Shoqëria

ALBGAZ është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu kompania ka nje zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

ALBGAZ është certifikuar nga ERE si një **transmetues i kombinuar gazi dhe shpërndarës** me Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 8.11.2017 "Për certifikimin e kompanisë si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror". Me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **shpërndarjes** së gazit natyror, dhe vendimin nr. 188, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **transmetimit** të gazit natyror. Përgjatë vitit 2021, ERE e ka miratuar me vendimin Nr. 190, datë 25.11.2021 “Mbi kërkesën e shoqërisë ALBGAZ për licensimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”. Të treja akoma të paplotësuara dhe të shtyra për plotësim në vitin 2022. Por me Vendimi nr.204, datë 04.12.2021. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”.

Rrjeti i tubacioneve në pronësi të ALBGAZ është i shpërndarë në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe përfundon në ORC në Ballsh. Infrastruktura vendase e rrjetit të gazit në Shqipëri



## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

ka një shtrirje më të madhe se infrastruktura e naftës. ALBGAS ka informuar se aktualisht është në procesin e evidentimit në terren, vlerësimin teknik të integritetit të linjave teknologjike dhe tubacioneve nëntokësore si dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis, për efekt të paisjes me Lejen Mjedisore

Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi deri në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për t'u lidhur me rrjetin. Infrastruktura e kufizuar e gazit vendas në Shqipëri në disa pjesë të saj është jashtë gjendjes operative dhe nevojiten punime të mëdha rehabilitimi. ALBGAS administron rreth 500 km tubacione magjistrale të transportit të gazit të ndertuar para më shumë se 40 vjetesh. Mendoj që tani ato janë me një teknologji tashmë të vjetëruar, ku masat mbrojtëse nga korozioni janë minimale.

Aktualisht objekti kryesor i aktivitetit të ALBGAS si një operator i kombinuar, është të ofrojë transportimin dhe shpërndarjen e gazit natyror nëpërmjet rrjetit të trasmetimit dhe shpërndarjes, dhe në të ardhmen të ofrojë edhe aktivitetin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror dhe të impiantit të gazit natyror të lëngëzuar.

ALBGAS si operator i kombinuar i gazit përgjatë 2021 ka proceduar për mbylljen e kërkesave ligjore përsa i përket çertifikimit dhe licensimit të shoqërisë me shkresat vendim ere nr. 152 datë 30.06.2021 “mbi certifikimin e shoqërisë operatori i kombinuar i gazit natyror albgaz sh.a., të ndryshuar. dhe me vendimin e bordit të ere-s nr. 153, datë 30.06.2021, “mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ere-s nr. 187, datë 10.11.2017, “për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe në vendimin e bordit të ere-s nr.188, datë 10.11.2017, “për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e trasmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar : dhe ndryshimet me vendim nr. 201, datë 01.10.2021 mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ere-s nr. 187, datë 10.11.2017, “për licencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe vendim nr. 202, datë 01.10.2021 një ndryshim në vendimin e bordit të ere-s nr. 188, datë 10.11.2017, “për icencimin e shoqërisë albgaz sh.a. në aktivitetin e trasmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.

ALBGAS gjithashtu përgjatë 2021 ka proceduar për mbylljen e kërkesave ligjore përsa licensimit të shoqërisë me shkresat vendim ere nr. 79, datë 23.03.2021 kërkesën e shoqërisë “albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ere nr. 195, datë 22.09.2021 mbi kërkesën e shoqërisë “albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ere, për licencimin e shoqërisë“albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

ERE ka zgjatur afatin për miratimin e programit të përputhshmërisë sipas vendimeve nr. 63, datë 01.03.2021 zgjatjen e afatit të vendimarrjes së bordit të ere-s në lidhje me miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të trasmetimit për gazin natyror, albgaz sh.a. : dhe nr. 85, datë 30.03.2021 zgjatjen e afatit të dorëzimit të programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të trasmetimit për gazin natyror, albgaz sh.a. : dhe nr. 171, datë 16.08.2021 miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të trasmetimit për gazin natyror, “albgaz” sh.a.

### 3. Programi i Përputhshmërisë

Monitorimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve është bazuar në katër parimet themelore (**ndarja dhe pavarësia, aksesit dhe shpërndarja e informacionit, përjashtimi i sjelljes diskriminuese dhe**

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

**zbatimi i rregullt i programit**) të programit sipas Vendimit të Bordit të ERE Nr. 77, datë 25.06.2017 “Mbi Miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, shqyrtohet se si aktiviteti i ALBGAS duhet të qeveriset sipas standarteve që përcakton legjislacioni në fuqi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë.

Kërkesat dhe parimet e mëposhtme rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për ALBGAS, dhe çdo strukturë e saj është e detyruar të realizoj dhe kërkojë përputhshmërinë me këto kërkesa dhe parime.

### A. Ndarja dhe pavarësia

#### 1. Ndarja

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAS nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”

- **ALBGAS i plotëson kërkesat e programit** pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Albgaz sh.a. nëpërmjet shkresës dalëse nr. 129/1 prot., datë 16.11.2021, në përmbushje të konstatimeve që i referohen pikës 5 dhe 6, të Kreut II, të Programit të Përputhshmërisë (Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST) dhe të pikës 15, të Kreut III, që ka të bëjë me ndarjen e pronësisë dhe pavarësinë e OST, Albgaz Sh.a. i ka bërë me dije Entit Rregullator të Energjisë se ka marrë të gjitha masat dhe aktualisht jemi në proces konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.
- Gjithashtu, duhet theksuar se shoqëria është në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, në të cilën MIE ka një rol kyç jo vetëm si institucioni përgjegjës për politikën e zhvillimit të sektorit të gazit natyror, por edhe të mbikëqyrjes së ecurisë së projekteve të zhvillimit dhe të ndërtimit të sistemit të ri të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në vend, në pozitën e pronarit të aksioneve të shoqërisë Albgaz sh.a., vijimi i mbajtjes së pronësisë së aksioneve të Albgaz sh.a. nga ana e MIE-së do të ishte i rëndësishëm për zbatimin dhe mbarëvajtjen e projekteve aktuale dhe atyre që priten të ndërmerren në të ardhmen e afërt.
- ALBGAS sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit , dhe shkresës së ALBGAS nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ka siguruar dhe garantuar ndarjen e duhur të ALBGAS, duke marrë masa që i njëjti person ose të njëjtët persona të emëruar, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ALBGAS të mos kenë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e subjektit që kryen veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror, si dhe të jenë anëtarët të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e ALBGAS ose rrjetit të transmetimit.

## 2. Pavarësia drejtuese

### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe nën pikat e saja, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa që për të arritur pavarësinë e drejtuesve. Për sa i përket pavarësisë së drejtuesve të ALBGAZ, të tillë si Anëtarët e Bordit Mbikqyrës, Administratori, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njëjësive strukturore), janë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, janë zbatuar kërkesat e mëposhtme:
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk janë të lidhur profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë interes apo marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Pagat e drejtuesve në Albgaz sh.a. vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e Albgaz sh.a., siç specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit.
- Transferimi i drejtuesve të Albgaz sh.a. tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, është parashikuar të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statuti i Albgaz sh.a. dhe do ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferime nuk do mund të paracaktohen që në fillim.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe nuk kanë konflikte të mundshme interesi që kanë lidhje me këto aksione.

## 3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse

### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse. ALBGAZ mbështetur në Ligjin nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit është përgjegjës për dhënien aksesit për palët e treta, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, ALBGAZ është përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re të gazit. ALBGAZ është e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetë-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë. ALBGAZ mban në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2021 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror Vendimmarrjet e mëposhtme lidhen me miratimin e kuadrit ligjor të ERE-s në funksion të zbatimit të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe përgatitja e kushteve të tregut me fillimin e operimit të gazit në vitin 2020, i cili përkon me startimin e projektit TAP.

Gjatë vitit 2021, për sektorin e gazit natyror, nga ana e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) janë miratur Vendimet si më poshtë:

Me Vendimin nr. 6, datë 15.01.2021, Bordi i ERE-s miratoi kërkesën e shoqërisë Albgaz sh.a., për ndryshimin e afateve të parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.100/2019 si më poshtë:

“Jo më vonë se 21.06.2021, OSSh-G, OST-G dhe çdo i Licencuar tjetër përkatës do të ndërtojnë mjetet e përshtatshme duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni), të aftë për të regjistruar dhe për të mundësuar aksesin në të dhënat aktuale dhe ato historike të Treguesve mbi Standardet dhe Performancën”.

Me Vendimin nr. 59, datë 25.02.2021, Bordi i ERE-s miratoi licencën tip për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror. Kjo vendimmarrje e ERE-s, mbështetet në përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe ka për qëllim të përcaktojë kushtet, të cilat duhet t’i përmbushë i licencuari në veprimtarinë e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

Me Vendimin nr. 60, datë 25.02.2021, Bordi i ERE-s miratoi standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit. Këto standarde përcaktojnë kushtet e përgjithshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të Licencuarit, si dhe kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve, në mënyre që të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit dhe të rritet besimi dhe kënaqësia e klientëve për këtë shërbim të ofruar nga të Licencuarit.

Me Vendimin nr. 72, datë 12.03.2021, Bordi i ERE-s miratoi rregullat operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror. Këto rregulla kanë për qëllim të përcaktojnë dhe të sigurojnë shërbimin publik të furnizimit me gaz natyror nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, në mbështetje të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Me Vendimin nr. 73, datë 12.03.2021, Bordi i ERE-s miratoi rregulloren mbi procedurat për dhënien e të drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror, e cila ka për qëllim të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jo-diskriminuese dhe të arsyetuar në përputhje me rregullat e Paketës së Tretë të Energjisë, si dhe synon të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, ndërkohë që siguron funksionimin si duhet të tregut të gazit natyror.

Me Vendimet nr. 79, datë 23.03.2021 dhe nr. 195, datë 22.09.2021, Bordi i ERE-s ka vendosur të pranojë kërkesat e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes për licencimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror. Shoqëria “Albgaz” sh.a. në kërkesat e paraqitura, ka bërë me dije ERE-n se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë Covid-19, dhe si e tillë shoqëria, nuk ka disponuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE. Gjithashtu, ERE

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

është informuar nga shoqëria “Albgaz” sh.a se është në proces kryerja e një studimi për hapësirat e depozitimit të gazit natyror dhe përfundimi i këtij studimi do të mundësojë edhe plotësimin e dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror depozitimit të gazit natyror. Në vijim të sa më sipër, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjen e vendimmarrjes përgjatë vitit 2022, lidhur me licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

Me Vendimin nr. 90, datë 06.04.2021, Bordi i ERE-s ka miratuar licencimin me kusht të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë) për një afat 10-vjecar.

Me Vendimin nr.120, datë 11.05.2021, Bordi i ERE-s ka miratuar një ndryshim në Vendimin nr. 15, datë 31.01.2019 të bordit të ERE-s, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”. Bordi i ERE-s ka miratuar që në vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, pas pikës 2, të shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje: a. Shoqëria TAP AG ALBANIA të përcjellë periodikisht në ERE certifikatën (policën) e sigurimit, pas rinovimit të saj, sipas kërkesave të nenit 9, pika 1, gërma “e”, iv, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.

Me Vendimin nr.121, datë 11.05.2021, Bordi i ERE-s miratoi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019. Kjo vendimmarrje erdhi pas kërkesës së paraqitur nga shoqëria Trans Adriatic Pipeline AG Albania për ndryshimin e kohëzgjatjes së licencës për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, nga 25 vjet në 30 vjet, duke e bazuar këtë kërkesë në nenin 23, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenin 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”. Në kërkesën e paraqitur, shoqëria TAP AG ALBANIA është shprehur se zgjatja e afatit të licencës së transmetimit nga 25 vjet deri në 30 vjet, do të siguronte harmonizimin e Licencës së transmetimit me lejen e veçantë të dhënë TAP-it me VKM nr. 123, datë 13.03.2019, duke theksuar se sipas nenit 5.2, të ligjit nr. 116/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, i ndryshuar, leja e vecantë rinovohet automatikisht nga Autoritetet Shqiptare, në përfundim të periudhës 30 vjecare, konkretisht më 21.03.2049.

Me Vendimin nr. 122, date 11.05.2022, Bordi i ERE-s miratoi propozimin e projektit te TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes të kapacitetit për vitin 2019”, sic shprehet në vendimin e përbashkët me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

Me Vendimin nr. 151, datë 29.06.2021, Bordi i ERE-s miratoi udhëzuesin për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik Pipeline, ashtu si edhe shprehet në vendimin e përbashkët me Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

Me Vendimin nr. 152, datë 30.06.2021, Bordi i ERE-s miratoi disa ndryshime në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar. Bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë pikën 5.1 dhe pikën 5.2 të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar, duke i lënë detyrë shoqërisë “Albgaz” sh.a të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë dhe të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.01.2022 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me Vendimet nr. 153, datë 30.06.2021; nr. 201, datë 01.10.2021 dhe nr. 202, datë 01.10.2021, Bordi i ERE-s vendosi përkatësisht të miratojë një Ndryshim në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe në Vendimin e bordit të ERE-s nr.188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar. Konkretisht, ndryshimet e miratuara në pikën 1 të vendimeve të Bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017 dhe nr. 188, datë 10.11.2017, përcaktojnë afatet për depozitimin në ERE të lejeve dhe autorizimeve mjedisore dhe certifikatën e sigurimit, depozitimi i të cilave është i nevojshëm për plotësimin e kushteve respektive të licencave të shoqërisë “Albgaz” sh.a në veprimtarinë e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

Me Vendimin nr. 154, datë 30.06.2021, Bordi i ERE-s miratoi modifikimin e licencës për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019. Modifikimi i licencës konsiston në ndryshimin e afatit të licencimit për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, nga 25 vjet në 30 vjet, nga data e fillimit të operimit.

Me Vendimin nr. 171, datë 16.08.2021, Bordi i ERE-s miratoi programin e përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a. me kushtin që shoqëria brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.

Me Vendimin nr. 172, datë 16.08.2021, u rishikua Vendimi i bordit të ERE-s nr. 90, datë 06.04.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)”, duke miratuar disa ndryshime lidhur me kushtet e vendosura në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 06.04.2021.

Me Vendimin nr.198, datë 01.10.2021, Bordi i ERE-s miratoi kërkesën e subjektit GEK TERNA GROUP, për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në treg -testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec Fier. Kërkesa e GEK TERNA Group u miratua nga ERE, pasi u vlerësua se ishte në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzimet e Testit të Tregut, Kodi i Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.

Me Vendimin nr. 212, datë 08.10.2021, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e kërkesës së subjektit DEPA COMMERCIAL S.A. për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në treg testi i

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

TAP AG për kapacitetin dhe lidhjen. Kërkesa e DEPA COMMERCIAL S.A. u miratua nga ERE, pasi u vlerësua se ishte në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, si të përcaktuara në paragrafin 4.7 të tij, Njoftimin e Fazës Jo-detyruese për Testin e Tregut TAP AG 2021, Udhëzimet për Testin e Tregut të 2021, Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.

Me Vendimin nr. 229, datë 15.11.2021, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së. Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i kritereve, kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit të realizuar nga operatori i sistemit të GNL-së bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me parimet dhe rregullat e miratuara në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit natyror të miratura me vendimin e bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.05.2017 si dhe akteve të tjera rregullatore që parashikojnë aktivitetin e Operatorit të sistemit të GNL-së. Me Vendimin nr. 236, datë 26.11.2021, Bordi i ERE-s miratoi zgjatjen e afateve të përcaktuara në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, “Për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.”. Zgjatja me 3 muaj e afatit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, u miratua pas kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a, e cila u shpreh se ka marrë të gjitha masat për të plotësuar kushtet e vendimit dhe aktualisht është në proces konsultimi me aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.

Vendim nr. 254, datë 21.12.2021. Lënia në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a.” për vitin 2022. Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, të nenit 13, pika 1, neni 16, pika 2, neni 17, gërma “e” dhe neni 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; neni 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 178, datë 18.11.2017; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, shqyrtoi relacionin me nr. 156/10 prot., datë 17.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2022”.

Me Vendimin nr. 256, datë 21.12.2021, Bordi i ERE-s miratoi licencën tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së. Kjo vendimmarrje e ERE-s, mbështetet në përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe ka për qëllim të përcaktojë kushtet, të cilat duhet t'i përmbushë i licencuari në veprimtarinë e operimit të impianteve të gazit natyror të lëngët.

### **Performanca e ALBGAS sh.a. për vitin 2021**

1) Terminali Rajonal i Gazit-Vlore (MOU MIE – Exxon Mobile – Albgaz)

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanive Amerikane, Exxon Mobil dhe Excelerate Energy, për vlerësimin e kuadrit rregullator teknik dhe komercial të futjes së Gazit Natyror të Lëngët (GNL) në Shqipëri.

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

Ky hap shënon një transformim të rëndësishëm, jo vetëm në importin e gazit natyror të lëngët me anije të vogla, por po studiohet mundësia e ndërtimit të një Terminali Rajonal në Gjirin e Vlorës, i cili do t'i shërbejë jo vetëm për vendosjen në punë të TEC Vlora (kapaciteti aktual plus kapacitet shtesë i cili është në fazë studimi fisibiliteti) por gjithashtu do të shërbejë potencialisht si një burim për Testin e Tregut të 2021, Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit. Në lidhje me pikën e fundit, palët angazhohen të eksplorojnë mundësitë e shfrytëzimit të depozitës nëntokësore të gazit natyror në Dumre, duke vënë në efikasitet një aset të rëndësishëm në këto kripëra sepse jo të gjitha vëndet e rajonit e kanë këtë mundësi, që do t'i shërbejë jo vetëm vëndit tonë, por edhe sigurisë së furnizimit me gaz natyror të rajonit por edhe më gjerë në Evropë. Objektivi kryesor i projektit të DNG-së së Dumresë është të kontribuojë në zhvillimin e sistemit shqiptar të gazit.

Depozitimi nëntokësor i gazit mundëson uljen e kostos së përgjithshme të furnizimit me gaz për konsumatorët fundorë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shtesë në tregjet e gazit, si fleksibiliteti i ofertës dhe kërkesës, dhe krijimi i mundësive përkatëse të tregtimit. Për depozitimin në vënd ekziston mundësia për rritjen e kapacitetit, ndërsa për depozitimet rajonale kapaciteti maksimal i kërkuar i injektimit është 113,000 m<sup>3</sup>/orë. Sasia maksimale e kërkuar e marrjes së gazit është 190,000 m<sup>3</sup>/orë. E gjitha kjo, do të shërbejë realizimit të politikave dhe prioriteteve tashmë të vendosura, për diversifikim të burimeve të energjisë, nëpërmjet një burimi të ri dhe të besueshëm siç është gazi natyror, duke u bërë pjesë aktive e ndërlidhjes me rrjetet e furnizimit ndërkombëtar siç është ai i TAP.

Kjo përpjekje dhe ky angazhim nga palët, është në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, lidhur ndërmjet MIE dhe ExxonMobil LNG Market Development Inc si dhe Excelerate Global Operations, LLC” e nënshkruar në fillim të këtij viti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të kryer një studim të fizibilitetit për zhvillimin e mundshëm të një Projekti GNL në Portin e Vlorës në Shqipërinë e Jugut. Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruhet nga përfaqësues të secilës palë, respektivisht nga Albgaz Sh.a; Excelerate dhe Snam Global Solutions. Planifikimi pritet të fillojë menjëherë me përfaqësuesit nga secila kompani që formojnë një ekip koordinues.

Avancimi i këtyre projekteve do të ndikojë në uljen e krizës energjitike në rajonin tonë, europë dhe në botë.

Me Vendimin nr. 229, datë 15.11.2021, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së. Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i kriterëve, kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit të realizuar nga operatori i sistemit të GNL-së bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me parimet dhe rregullat e miratuara në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit natyror të miratura me vendimin e bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.05.2017 si dhe akteve të tjera rregullatore që parashikojnë aktivitetin e Operatorit të sistemit të GNL-së.

Me Vendimin nr. 236, datë 26.11.2021, Bordi i ERE-s miratoi zgjatjen e afateve të përcaktuara në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, “Për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.”. Zgjatja me 3 muaj e afatit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, u miratua pas kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a, e cila u shpreh se ka marrë të gjitha masat për të plotësuar kushtet e vendimit dhe aktualisht është në proces konsultimi me aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.



## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

Vendim nr. 254, datë 21.12.2021. Lënia në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a.” për vitin 2022.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “ Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, të nenit 13, pika 1, nenit 16, pika 2, neni 17, gërma “e” dhe neni 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 178, datë 18.11.2017; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, shqyrtoi relacionin me nr. 156/10 prot., datë 17.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2022”.

Me Vendimin nr. 256, datë 21.12.2021, Bordi i ERE-s miratoi licencën tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së. Kjo vendimmarrje e ERE-s, mbështetet në përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe ka për qëllim të përcaktojë kushtet, të cilat duhet t’i përmbushë i licencuari në veprimtarinë e operimit të impianteve të gazit natyror të lëngët.

### B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit, për të parandaluar ndonjë trajtim diskriminues nga ana e ALBGAZ.

#### 1. Aksesi në sistemin e transmetimit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues. Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” shoqëria Albgaz sh.a ka hartuar dhe dërguar për miratim “Programin e Perputhshmërisë” i cili është filtri/garancia e fundit për garantimin e zbatimit me përpikmëri të dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Albgaz sh.a. ka marrë të gjitha masat për të siguruar akses të barabartë dhe jo diskriminues në sistemin e transmetimit.

#### 2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e programit. Për sa i takon konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale, përgjate vitit 2021 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të vecanta. Aktivitetet e ALBGAZ nuk kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror

### 3. Konflikti i interesit

#### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit. Në lidhje me konfliktet e interesit, përgjatë vitit 2021, nuk është sinjalizuar asnjë shkelje apo abuzim i punonjësve të shoqërisë ALBGAZ nga ana e Bilbilfryresit apo e ndonjë individi tjetër të brendshëm apo të jashtëm të shoqërisë.

### C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ

ALBGAZ ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

#### 1. Sigurimi i informacionit

#### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit. Pavarësisht faktit se aktualisht ALBGAZ ka vetëm një përdorues të rrjetit të transmetimit të gazit, ALBGAZ i siguron atij, pjesëmarrësve potencial dhe përdoruesve të mundshëm të rrjetit informacionin e nevojshëm për akses eficient dhe të pa-kufizuar tek sistemi i transmetimit. Ky informacion sigurohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe jo-diskriminuese sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.
- Përditësimi i faqes zyrtare të OST-G për të përfshirë Programin e Përputhshmërisë. Në kuadër të promovimit dhe të krijimit të një imazhi sa më profesional dhe transparent të Shoqërisë Albgaz Sh.a., si OST, lindi nevoja për një restaurim nga e para e faqes së ëëbsite zyrtar duke krijuar një faqe të re të ëëbsite-it zyrtar. Faqja e web-it [www.albgaz.al](http://www.albgaz.al) aktualisht është e paaksesueshme për publikun sepse faqja është në përpunim e sipër. Në modelin e ri që po krijohet janë programuar dhe llogaritur fusha të posaçme, konkretisht një rubrikë me emrin “Dokumenta”, në të cilin është parashikuar që të vendoset i gjithë informacioni në lidhje me përputhshmërinë duke e ndarë atë në fusha të caktuara, në mënyrë që të ketë informacion të plotë dhe të përditësuar.
- Rubrika Dokumenta Nënfisha
- Detyrat e Zyrtarit të Përputhshmërisë
- Programi i Përputhshmërisë
- Raportet vjetore të përputhshmërisë
- Njofto/Raporto tek Zyrtari i Përputhshmërisë (ku do të jetë një adresë emaili e cila do të lidhet direkt me Zyrtarin e Përputhshmërisë)
- Sipas parashikimeve, faqja zyrtare e shoqërisë Albgaz Sh.a, do të jetë e aksesueshme në fillim të muajt nëntor 2021.

## 2. Konfidencialiteti i informacionit

### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit. Nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe mekanizmave të tjerë juridik, ALBGAZ siguron konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar, financiare ose teknike të cilat iu vijnë drejtuesve ose punonjësve të shoqërisë gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre profesional. ALBGAZ ruan informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave me furnizuesit e produkteve dhe/ose shërbimeve. Këta furnizues duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre, që e marrin këtë informacion konfidencial nga ALBGAZ, ta ruajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion. Stafi i shoqërisë ka marrë të gjitha masat që materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregëtar siç janë (dokumentat, arkivues të të dhënave elektronike, kompjutera, tableta, telefonat etj.) të mbrohen në bazë të protokolleve në fuqi sipas vendit të punës. ALBGAZ gjithashtu nuk shpërndan informacionin e ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë, përveç rasteve kur: Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të përcaktuar me ligj. Drejtuesit dhe/ose punonjësit e ALBGAZ sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshillëtarët nuk shpërndajnë ose kanë shpërndarë informacion të ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë gjatë emërimit të tyre, punësimit ose bashkëpunimit me ALBGAZ dhe të paktën 3 (tre) vitet në vazhdim pas mbarimit të emërimit, punësimit, dhe bashkëpunimit (vetëm sipas rasteve të cituara në ligj). Në përputhje me kërkesat e transparencës të ALBGAZ, siguron që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e ALBGAZ. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregëtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në faqen e internetit të ALBGAZ. Vlen të theksohet, që në fillimet e shoqërisë Albgaz sh.a, konfidencialiteti i informacionit ka qënë objekt kryesor vëmendje. Në kontratën e punësimit neni 16 “Konfidencialiteti dhe konflikti i interes”, pra çdo punonjës i shoqërisë Albgaz ka detyrim kontraktual të ruajë konfidencialitetin e informacionit, përveç zbatimit të Programit të përputhshmërisë.

## 3. Informacioni publik

### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit. ALBGAZ ka publikuar në faqen e internetit informacionet që nuk klasifikohen si konfidencial ose informacione të ndjeshëm tregëtar duke vendosur në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të treta informacionin e lidhur me listën e shërbimeve të ofruara nga ALBGAZ, informacion për tarifatat dhe kushtet e tjera për sigurimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë kushtet teknike për aksesin dhe

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

lidhjen me sistemin e transmetimit. Shoqëria “Albgaz” sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 138/1 prot., datë 01.12.2021 ka kërkuar që për vitin 2022 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit. ERE me vendim nr. 254, datë 21.12.2021 mbi “Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a.” Në mungesë të paraqitjes së një aplikimi për rishikimin e tarifës së transmetimit të shoqërisë Albgaz sh.a. për vitin 2022, paraqitjes së planit të investimeve për vitin 2022 si një komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2022, si dhe në zbatim të direktivave të Komunitetit të Energjisë, meqënëse aksesimi në rrjet për përdoruesit e Sistemit të Transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE me vendimin nr. 254, datë 21.12.2021 vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit Nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2022, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., ku përditësimi dhe kompensimi i të ardhurave të kërkuara të shoqërisë Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme do të bëhet në mbështetje të përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

### D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, është i krijuar i tillë që të ketë formën e një rregulloreje, apo udhëzimi me angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAZ, siç janë audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

#### Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 49/1 Prot datë, 17.05.2022 “kthim përgjigje shkresa nr. 49/4 prot datë, 31.03.2022”**: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit**. Referuar vendimit Nr.78 datë 26.05.2017 të ERE, monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin, siç duhet, të Programit është kryer nga Zyrtari i Përputhshmërisë i cili ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të ofruara sipas Ligjit Nr 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kontratës së lidhur midis ALBGAZ dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë. Zyrtari i Përputhshmërisë ka ushtruar autoritet të mjaftueshëm në kushtet e dhura financiare dhe organizuese që i kanë mundësuar, propozimin e masave për të siguruar zbatimin e këtij Programi dhe të kërkojë bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ për të siguruar përputhshmërinë me këtë Program. Zyrtari i Përputhshmërisë ka pasur akses pa limit tek të dhënat e nevojshme në zyrat e ALBGAZ dhe tek gjithë informacioni që i është dashur për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Përputhshmërisë ka pasur akses në zyrat e ALBGAZ pa pasur nevojën e një njoftimit paraprak. Zyrtari i Përputhshmërisë ka marrë pjesë në një pjesë të madhe të mbledhjeve të drejtuesve të ALBGAZ dhe organeve korporative, përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikqyrëse dhe drejtuese, të cilat e kanë informuar Zyrtarin e Përputhshmërisë paraprakisht për takimet e programuara dhe i ka siguruar të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në takime. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Zyrtari i Përputhshmërisë ka dhënë opinionin e tij në lidhje me disa dokumenta të brendshëm si dhe veprime të ALBGAZ në lidhje me përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët kanë konfirmuar me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta zbatojnë atë. Të gjithë drejtuesit e ALBGAZ dhe

punonjësit janë udhëzuar rregullisht për zbatimin e këtij programi të paktën një herë në vit. Drejtuesit e rinj dhe punonjësit janë udhëzuar për programin nga Zyrtari i Përputhshmërisë para se të fillojnë mandatin e tyre.

---

## *PJESA E DYTË*

---

### **4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë**

Në raportin e vitit 2021, ALBGAZ ka plotësuar të gjitha rekomandimet por rekomandimet e mëposhtë do jenë gjithmonë të aktive dhe koherente.

- **Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin**

Kodi i Etikës aktual i përdorur nga ALBGAZ është shumë i mirë por kërkon një përmirësim duke shtuar pjesë nga Programi i Përputhshmërisë. Do shikohet përgjatë vitit 2022.

- **Përditësim/përmirësim i Programit**

Programi është një produkt i ri dhe kërkon sipas kohës të përditësohet dhe të kihet parasysh që të jetë sa më koherent me standardet e industrisë.

- **Miratimi i Programit të Përputhshmërisë**

---

## *PJESA E TRETË*

---

### **6. Detyrat specifike të lëna nga ERE për vitin 2022.**

Disa probleme për të ardhmen në sektorin e gazit natyror të cilat do jenë si detyra për Zyrtarin janë si më poshtë:

Trajtimi i kërkesave të ALBGAZ sh.a. për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve të Licencimit. Përgjatë vitit 2022, ERE ka trajtuar kërkesat e shoqërisë Albgaz sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes së ERE-s në lidhje me shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror si dhe shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit në aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes deri në datën 20.01.2022 për depozitimin e Lejeve dhe Autorizimeve Mjedisore dhe Certifikatës së Sigurimit.

Shtyrjet e afateve procedurale për plotësimin e programit të përputhshmërisë.

---

## *PJESA E KATËRT*

---

### **7. Konkluzione**

Raporti i parashtruar përcakton se, në vitin 2021 (viti i katërt i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë dhe raportimit mbi programin bazë), ALBGAZ në kuadër të angazhimeve të marra përsipër nga OST me çertifikimin e tij si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror, shoqëria ka bërë përpjekje dhe është angazhuar në përmbushjen e kushteve të pavarësisë së shoqërisë si dhe trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit të transmetimit në drejtim të transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë përdoruesit në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator që drejton sektorin e gazit natyror. Përmbushja e kritereve të përcaktuara në programin e përputhshmërisë kërkon një bashkëpunim më të ngushtë dhe të vazhdueshëm të organeve drejtuese si dhe të stafit të shoqërisë me zyrtarin e përputhshmërisë, duke synuar identifikimin dhe shmangien në të ardhmen të rasteve të sjelljeve diskriminuese ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, ruajtjen e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar si dhe pavarësinë e stafit drejtues dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë në shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Ndërgjegjësimi i stafit të shoqërisë mbi programin e përputhshmërisë si dhe respektimi i detyrimeve të përcaktuara në të, të monitoruara prej zyrtarit të përputhshmërisë do të ndihmojë në krijimin e një kulture korporative mbi çështjet e përputhshmërie.

Në përfundim, përfshirja e zyrtarit të përputhshmërisë, brenda kuadrit të detyrave të ngarkuara nga programi i përputhshmërisë dhe kontrata e zyrtarit, si dhe informimi i vazhdueshëm i tij nga strukturat përkatëse mbi çdo problematikë të shfaqur dhe që cënon shtyllat kryesore që sigurojnë parimet themelore të veprimtarisë së ALBGAZ, konsiderohet një hap i rëndësishëm për mbikqyrjen dhe garantimin e respektimit të këtyre parimeve.

Raporti i vitit 2021 nuk nxjerr në pah ndonjë shkelje apo nuk konstaton që ALBGAZ të ketë shkelur apo të mos ketë plotësuar kërkesat për përputhshmërinë e kompanisë.

Përgjatë vitit 2021 në funksionim e shoqërisë ALBGAZ kanë ndodhur shumë ndryshime dhe përmirësime. Mund të themi që dhe 2021 ka lënë hapur të vetmin problematikë – çertifikimin dhe licensimin dhe programi i përputhshmërisë së ALBGAZ.

Duhet theksuar që ALBGAZ ka komunikim me, **por kërkohet më shumë komunikim dhe informim ndaj Zyrtarit përsa i përket zbatimit të programit. Kjo është një nga sygjerimet që ALBGAZ duhet të përmirësojë në lidhje me zbatimet ligjeve dhe programit të përputhshmërisë.**

Në kushtet që ndodhet tregu i gazit në vënd, zhvillimi i aktivitetit të ALBGAZ dhe zhvillimi i tregut të gazit është një proces i rëndë si në volume projektimi dhe financimi. Kërkohen gjithashtu dhe burime njerëzore të mëdha dhe të kushtueshme, sëbashku me shtrirje kohore të zgjeruara. Por për të arritur këto rezultate në mënyrë graduale duhet që ALBGAZ të:

- Krijoj kushtet për përfitim të investimeve të huaja direkte në këtë segment të industrisë;

## Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2021

- Rritjen e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
- Përmirësimin e furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
- Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kALBGAZosh energjitike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
- Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
- Krijimin e kapaciteteve njerëzore në vend në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

Finalizimi i këtij procesi është vendimmarrja e Entit Rregullator të Energjisë me vendim nr. 99, datë 24.06.2020, me anë të të cilit ka vendosur shfuqizimin e pikave 2,3 he 4 të Vendimit të ERE-s n.43, datë 15.03.2017 "Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a" duke permbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në nenin 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, \*Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenin 9 të Direktivës 72/2009 EC, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke lënë detyrimin për OST të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë. Ritheksoj faktin se përmbushja e kritereve të përcaktuara në programin e pajtueshmërisë kërkon një bashkëpunim me të ngushtë dhe të vazhdueshëm të organeve drejtuese si dhe të stafit të shoqërisë me zyrtarin e pajtueshmërisë, duke synuar identifikimin dhe shmangien në të ardhmen të rasteve të sjelljeve diskriminuese ndaj perdoruesve të sistemit të transmetimit, ruajtjen e të shoqërisë me zyrtarin e pajtueshmërisë, duke synuar identifikimin he shmangien në të ardhmen të rasteve të sjelljeve diskriminuese ndaj perdoruesve të sistemit të transmetimit, ruajtjen e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar si dhe pavarësinë e stafit drejtues dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë në shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyres se tyre. Ndërgjegjësimi i stafit të shoqërisë mbi programin e pajtueshmërisë si dhe respektimi i detyrimeve të përcaktuara në të, të monitoruara prej zyrtarit të pajtueshmërisë do të ndihmojë në krijimin e një kulture korporative mbi çështjet e pajtueshmërisë.

**Tiranë, 31.03.2022**

**Elvis Ponari, MBA, MSc**

**Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAS Sh.a**